USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

INFORMATORI

Iniciativa "Rinia, e ardhmja" në Gjakovë

KU TË REGJISTROHEM NË SHKOLLË TË MESME?

66

Shkolla Profesionale

46

Mijë nxënës

A je nxënës që të pëlqejnë shumë lëndë dhe nuk mund të vendosësh cila të shkon më shumë?

Të pëlqen të studiosh një lëmi por mendon që nuk ka perspektivë për punë?

Të përcaktosh drejtimin për vazhdimin e shkollimit të mesëm është një nga sfidat kryesore për nxënësit që përfundojnë shkollimin fillor.

Në Kosovë janë gjithsej 66 shkolla profesionale ku vijojnë mësimin 46 mijë nxënës.

SHKOLLA E MESME TEKNIKE "NEXHMEDIN NIXHA"

TEKSTIL



Çka bëhem me këtë drejtim?
Rrobaqepës/e, është një profesion shumë i kërkuar në tregun e punës. Shkolla posedon mjete të mjaftueshme për punë praktike dhe çdo njohuri e fituar teorike, shndërrohet në praktikë.

NDËRTIMTARI

Arkitekt/e, mësoni artin e projektimit, të arkitekturës së ndërtesave dhe objekteve në përgjithësi. Shkolla ofron edhe punën praktike për këtë sektor.



ELEKTROTEKNIKË

Elektroteknik/e i/e energjisë, mësoni përdorimin e llojeve të ndryshme të energjisë dhe prodhimin e energjisë elektrike.

Instalues/e elektrik/e, mësoni të riparoni, instaloni dhe të mirëmbani pajisjet dhe makineritë elektrike si dhe sistemet e instalimeve elektrike. Me këtë profesion gjithashtu instaloni sisteme për komunikim, dritat në rrugë, apo të ngjashme.

Njohës i teknologjisë kompjuterike, mësoni përpunimin e informacioneve automatike si, pranimin e informacioneve dhe pajisjeve hyrëse, shndërrimin e tyre në sinjale, përçimin në linja për komunikim brenda kompjuterit me teknika të ndryshme, vendosjen në kujtesën kompjuterike, përpunimin nga njësia qendrore njehsuese (procesori) me ndihmën e programit kompjuterik.



MAKINERI

Operator/e i/e prodhimit, mësoni rreth planifikimit, koordinimit dhe kontrollimit të procesit të prodhimit. Operatori i prodhimit sigurohet që burimet përdoren në mënyrë sa më efikase.

Detyrat kryesore të këtij sektori janë:

- Përzgjedhja e veglave, paisjeve dhe materialeve të duhura të makinerisë;
- Përgatitja e skicave të thjeshta për përpunimin e detajeve të makinerisë;
- Kryerja e skicave dhe vizatimeve teknike;
- Kryerja e punimit të nivelit mesatar të shpimit, saldimit me hark dhe gaz, tornimit, filetimit dhe frezimit.



Të gjitha këto mësohen më së miri kur praktikohen, e këtë gjë e gjeni tek shkolla jonë.



Ndërtues/e e transportit rrugor, mësoni të ndërtoni rrugë për transporte të ndryshme, të krijoni rregullimin e mjeteve për transport. Edhe në këtë sektor nuk mungon puna praktike.

Automekanik/e, nëse keni talent dhe i njihni makinat mund të drejtoheni për shkollim tek ne. Shkolla ofron praktikë të mjaftueshme për rregullimin dhe mirëmbajtjen e makinave. Ky drejtim ofron bursa për vajzat dhe djemtë të cilët kanë arritshmëri të lartë në mësime.

SHKOLLA E MESME EKONOMIKE “KADRI KUSARI”

Ekonomist/e, kjo fushë ligjëron materiale që lidhen me prodhimin, përdorimin dhe administrimin e burimeve. Shkolla ofron punë praktike në bashkëpunim me bizneset private.



Agronom/e, një profesion shumë i vjetër. Bujqësia është praktikë e kultivimit të bimëve dhe rritjes së kafshëve me qëllim konsumi apo të ngjashme. Është njëra prej sektoreve më të rëndsishme dhe më me ndikim në mjedis. Ndryshimi në bujqësi po ndodh dita ditës dhe së fundmi po punohet në drejtim të bujqësisë organike dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Teknolog/e ushqimi, mësoni për teknika të ndryshme të prodhimit, kontrollimit dhe shitjes së ushqimit. Përdorni aparatura të duhura të cilat ofrojnë ushqim të sigurt.

Menaxhment hotelierik, mësoni se si bëhet menaxhimi i hotelit, si të siguroni kushte të rehatshme dhe të jeni përgjegjës për shërbime cilësore në hotele dhe komplekse turistike.

SHKOLLA E MESME E MJEKËSISË "HYSNI ZAJMI"

Infermier/e, në këtë drejtim mbani ligjërata me profesionistë shëndetësorë dhe keni mundësi të kryeni punë praktike të monitoruar në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare. Disa nga drejtimet tjera që mësohen në këtë drejtim janë: Mamia, Pediatria dhe Stomatologjia.

QENDRA PËR ARSIM DHE KËSHILLIM PROFESIONAL "GJON NIKOLLË KAZAZI"

EKONOMI

Kontabilist/e dhe Financier/e, mësoni për procese që merren me grumbullimin, përpunimin dhe raportimin e informatave financiare.

Administrues/e biznesi, në kuadër të kësaj dege përfshihen të gjitha aspektet e udhëheqjes dhe mbikqyrjes së operacioneve të biznesit. Edhe kjo degë ofron punë praktike në bashkëpunim me biznese të ndryshme të komunës së Gjakovës.

Banka dhe Financa, mësoni dhe praktikoni njohuritë rreth menaxhimit të bankave që kanë të bëjnë me detyrat dhe e objektivat e kësaj dege.

TEKNIKË



Dizajner/e grafik/e, një aftësi e të kombinuarit të tekstit dhe fotografive për reklama, revista ose libra. Mësoni përdorimin e imazheve, simboleve apo edhe fjalëve. Ky drejtim poashtu mbulon edhe dizajnin në internet dhe atë të shtypur.

Elektroinstalues/e, mësoni për prodhimin, bartjen dhe shpenzimin e rrymës elektrike. As në këtë drejtim nuk mungon pjesa praktike dhe shkolla ofron mjete të mjaftueshme për aplikimin e praktikës.

Iniciativa "Rinia, e ardhmja" në Gjakovë mbështetet nga Agjencioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) përmes aktivitetit Up to Youth.

Up to Youth është aktivitet pesë vjeçar i përkushtuar që të përmirësojë kapacitetet e rinisë dhe të krijojë mundësi për aspiratat e rinisë, në mënyrë që ata të kontribuojnë dhe të përfitojnë nga komunitete më të qëndrueshme, më demokratike dhe më prosperuese.

Përmbajtja është përgjegjësi e Global Communities dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.